



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “AZ Group” Sh.P.K. të datës 14.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “AZ Group” Sh.P.K. e datës 14.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “AZ Group” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “AZ Group” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 14.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** *“Sipas nenit 69 te aftesive teknike dhe profesionale ne gjate shqyrtimit te dokumentave te Invest PRO SH.P.K MI FIX COMPANY L.L.C kemi hasur ne disa parregullsi Tek inxhinieri Nazif Nazifi ne dyshojm qe eshte i falsifikuar per arsyen se ne kontrate eshte komplet i ndryshem me te cv nuk perngjan as per se aferm me ate te cv. Operatori ne fjale nuk i ka permbushur specifikimet teknike qe jane te cekura tek dosja e tenderit siq ka qene Aneksi 7 qe ka qene i obligueshem qe ta mbushim me te gjitha te dhenat , por operatori ne fjale nuk e ka permbushur dhe nuk e ka te dorezuar sipas dosjes se tenderit. Operatori ekonomik Sigurimin e tenderit nuk e ka bere ne emer te konzerciumit por vetem ne emer te Invest Group SH.P.K.”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka trajtuar të gjitha pretendimet e paraqitura në kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimet e parashtruesit** fillimisht duhet sqaruar që sa i përket pikës lidhur me falsifikimin e nënshkrimit kjo çështje është në kompetencën ekskluzive të komisionit vlerësues. Në rastin konkret komisioni vlerësues nuk ka identifikuar ndonjë bazë për dyshim lidhur me falsifikimin e nënshkrimit sikurse pretendon parashtruesi. Pavarësisht kësaj parashtruesi ka mundësi që lidhur me këtë aspekt të drejtohet te organet kompetente për këtë çështje. Rrjedhimisht kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar. Tutje, sa i përket pikës së pretendimit ankimor lidhur me sigurimin e tenderit duhet cituar nenin 71 paragrafin 4 të LPP ku përcaktohet se *“ Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”*. Në rastin konkret lideri i grupit e ka dorëzuar policën e sigurimit sipas nenit 68 të LPP dhe në përputhje me dosjen e tenderit. Për parashtruesin nuk është kontestues fakti që është dorëzuar deklarata e sigurimit nga lideri i grupit dhe në emër të grupit sipas dosjes së tenderit. Rrjedhimisht edhe kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar. Sa i përket pikës së pretendimit ankimor se nuk është plotësuar aneksi 7 i dosjes së tenderit nga tenderuesi i rekomanduar, fillimisht parashtruesi nuk e ka specifikuar fare se sipas pretendimit të tij cila pjesë e aneksit nuk është plotësuar konkretisht. Sidoqoftë nga ekzaminimi i dokumentave ofertuese, komisioni në mënyrë të drejtë ka gjetur se në këtë rast të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke përfshirë edhe aneksin 7 janë plotësuar në mënyrë të rregullt nga tenderuesi i rekomanduar. Prandaj edhe kjo pikë e pretendimit ankimor të parashtruesit është e pabazuar në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 25.10.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.